

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë: 15.07.2016
Kodi i ZRRE-së: V_836_2016

Bordi i Zyrës së Rregulatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregulatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1493_035_16**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **01.07.2016**

në seancën e mbajtur më datë 15 korrik 2016, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHEȚ** ankesa e KESCO-së - Divizioni i Furnizimit, ndaj vendimit të konsumatorit B. Q. me shifër DGL – 16739, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **Mbetet** në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1493_035_16** i datës 31.05.2016.

A r s y e t i m

Zyra e Rregulatorit për Energji me datë 01.07.2016 ka pranuar ankesën e parashtruar nga KESCO-së, Divizioni i Furnizimit me të cilën është kundërshtuar vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE për këto shkaqe: KESCO, ne ankesë e saj ka atakuar vendimin e DMK duke u mbështetur në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik të datës 26.03.2015 në të cilin është theksuar se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.7077018 me gjendje TL=50866 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=61499 kWh (tarifa e ulët), si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr.16079623 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh.

Gjithashtu KESCO, në ankesë është bazuar edhe në procesverbalin e qendrës së kalibrimit në të cilin është konstatuar se, “njehsori elektrik bllombat (vulat) e prodhuesit i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori elektrik dëmtime nuk ka kurse në brendi të njehsorit është vërejtur se sistemi i fazës “T” është i djegur dhe si pasojë njehsori elektrik ka regjistruar energji elektrike 33.33% më pak”.

Mbi ketë bazë si dhe duke u bazuar në rrjedhën e faturimit të energjisë elektrike të marra nga CCP KESCO, konsideron se me të drejt ka bërë korrigimin plotësues në vlerë financiare prej 243.14€, pasi që sipas saj ky korrigjim është konform nenit 4.11.1 të kodit të matjes së operatorit të sistemit dhe shpërndarjes.

KESCO ne ankesë nuk është pajtuar me vendimin e DMK-së në të cilin theksohet se shpenzimet e energjisë elektrike me njehsorin e ri janë më të ulëta në krahasim me njehsorin e vjetër, sipas KESCO-së, kjo është e mundur për faktin se konsumatori ka mundësin e ndërrimit të pajisjeve apo



zëvendësimit të tyre në mënyrë që ti ulë shpenzimet e energjisë me njehsor të ri si dhe arsyet tjetër sipas KESCO-së, ekziston një tendencë që me rastin e ndërrimit te njehsorit nga analog në digjital, konsumi i përgjithshëm i energjisë është më i vogël.

Po ashtu KESCO në ankesë ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së që me rastin e shqyrtimit të ankesës të ketë parasysh se ne raste të tilla kur matja nuk është e saktë atëherë me rastin e kalkulimit te korrigjimit nuk mund të merret mesatarja e energjisë me njehsorin e ri pasi që nuk mund të ketë të dhëna për kohen e ardhme. KESCO, gjithashtu nuk është pajtuar me konstatimet në vendimin e DMK-së në lidhje me mos regjistrimin e pajisjeve me rastin e ndërrimit te njehsorit elektrik me arsyetimin e tyre se ne rastin konkret nuk kemi te bëjmë me shfrytëzim te paautorizuar te energjisë andaj kalkulimi është bërë duke u bazuar në fuqinë e angazhuar.

Bordi i Zyrës së Rregulatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 15.07.2016 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga ana e KESCO-së si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve si vendim i shkallës së parë dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së pasi analizoi procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik numër 050493 i datës 26.03.2015 vërtetoi se organi i shkallës së parë DMK me të drejt ka konstatuar se punëtorët e autorizuar të KEDS nuk kanë regjistruar edhe pajisjet të cilat i ka poseduar konsumatori në momentin e ndërrimit të njehsorit elektrik. Lidhur me ketë Bordi konstatoi se regjistrimi i pajisjeve ka qenë shumë i nevojshëm edhe për vetë ankuesin KESCO, për faktin se në njërin nga pikat kontestuese në ankesë ka theksuar se indikator i mundshëm për uljen e mesatares së shpenzimit me njehsor të ri ka mund të jetë ndërrimi i pajisjeve apo zëvendësimi i tyre pas ndërrimit të njehsorit nga ana e konsumatorit, andaj nëse ekipet e KEDS do të evidentonin pajisjet siç edhe janë të detyruara në raste të tilla do të hiqeshin dyshimet e ankuesit për ndërrim/zëvendësim të pajisjeve në ketë pikë matëse.

Bordi i ZRRE-së gjithashtu pasi analizoi konstatimet e bëra në procesverbalin e kalibrimit me numër 49/19 të datës 19.05.2015, konstatoi se është e paarsyeshme nga ana e KESCO që të konstatohen parregullsi nga laboratori e të mos kërkohet që të bëhet shqyrtimi i saktësisë së matjes për njehsorin elektrik nr. 7077018 pasi që ka qenë e domosdoshme të bëhet një veprim i tillë.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe rrjedhat e energjisë elektrike të konsumatorit dhe nga kjo ka vërtetuar se DMK ka analizuar saktë mesataren e shpenzimit te energjisë elektrike me njehsor të vjetër dhe njehsor të ri. Bordi ka analizuar edhe pikën kontestuese të theksuar në ankesë se DMK me rastin e vendosjes nuk ka dashtë të marrë për bazë mesataren e shpenzimit te energjisë me arsyetimin se shpenzimet me njehsor te ri elektrik janë të pakta për shkak kohës së shkurtër pas ndërrimit të njehsorit elektrik. Për ketë pikë kontestuese Bordi ka konstatuar se nuk qëndrojnë këto arsyet te ankuesit KESCO për faktin se periudha e ndërrimit të njehsorit elektrik është bërë me datë 26.03.2015, ndërsa DMK ka analizuar mesataren e energjisë elektrike afersisht 9 muaj pas ndërrimit të njehsorit elektrik pasi që ka nxjerrë vendimin me datë 31.05.2016.

Bordi po ashtu ka vlerësuar si të arsyeshëm vendimin e shkallës së parë në të cilin janë pasqyruar saktë të dhënat e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsor të vjetër dhe njehsor të ri. Bordi ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike me njehsor elektrik nr.7077018 për periudhën 04/2014 deri në periudhën 04/2015 është **1,171 kWh/muaj**, si dhe shpenzimet me njehsorin elektrik nr. **16079623** periudha 04/2015 deri në periudhën 04/2016 është **616 kWh/muaj** dhe nga kjo ka vërejtur se përkundër asaj që është theksuar nga ankuesi KESCO konsumatori ka rënje të shpenzimit të energjisë elektrike prej **90%** për ketë periudhë. Për më tepër është analizuar edhe mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.7077018 prej periudhës **07/2002** e deri më



04/2015 ku shpenzimi ka dal të jetë **953.11 kWh/muaj**, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.16079623 prej periudhës 04/2015 e deri më 04/2016 është **616.15 kWh/muaj**, e që sipas kësaj vërehet se me njehsorin elektrik të ri konsumatori ka rënje të shpenzimit të energjisë elektrike për **54.69 %**.


Bordi ka konstatuar se organi i shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë pasi që janë analizuar në detaje rrjedhat e energjisë elektrike për ketë pikë matëse dhe të gjitha procesverbalet tjera të lëshuara nga ana e KEDS/KESCO dhe mbi ketë bazë ka konstatuar se KESCO në ankesën e saj nuk ka ofruar asnje provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në rregulla dhe ligje.


Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 15.07.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.


- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, Divizioni i Furnizimit,
- Konsumatorit B.Q., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.